



## VENDIM

Nr. 205, datë 9.3.2020

**PËR NJË SHITESË FONDI NË  
BUXHETIN E VITIN 2020, MIRATUAR  
PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE, PËR  
MARRJEN E MASAVE PËR  
PLOTËSIMIN E NEVOJAVE  
PARAPRAKE PËR INFEKSIONIN E  
SHKAKTUAR NGA COVID-19**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi”, i shtohet fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh për marrjen e masave për plotësimin e nevojave paraprake për infeksionin e shkaktuar nga COVID-19, i ndarë, përkatësisht:

- 200 000 000 (dyqind milionë) lekë në kategorinë e shpenzimeve kapitale;
- 200 000 000 (dyqind milionë) lekë në kategorinë e shpenzimeve korrente.

2. Efekti financiar, prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**